



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KËLCYRË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 19.10.2021

Drejtuar: *Operatorit Ekonomik "A & E ENGINEERING" sh.p.k*

Adresa: *Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.10, Rruga Islam Alla, pallati IVEA 3/5*

Procedura e prokurimit/lotit: **Mbikqyrje e punimeve me objekt: "Ndërtim Ujësjiellësash për njësinë administrative Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, Loti I (Nj.A Ballaban & Sukë)".**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-06242-09-23-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *Objekti është: Mbikqyrje e punimeve me objekt: "Ndërtim Ujësjiellësash për njësinë administrative Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, Loti I (Nj.A Ballaban & Sukë)".*

Kohëzgjatja e kontratës: Kohëzgjatja në muaj 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i kontratës

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.142 datë 27 Shtator 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **Operatori Ekonomik:"ARENA MK "shpk**

Emri i plotë i shoqërisë

NIPT L67619801Q

Numri i NIPT-t

Vlera **2,886,919** (dy milion e teteqind e tetedhjetë e gjashtë mijë e nenteqind e nentembedhjetë) **leke pa TVSH**

2. Operatori Ekonomik: "A & E ENGINEERING" sh.p.k

NIPT K72113010E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **2,893,629** (dymilion e tetëqind e nëntëdhjetë e tremijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë) **leke pa tvsh**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: "ARENA MK" shpk, me nr. NIPTI **L67619801Q**, pwr arsytet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik "ARENA MK" shpk nuk ka arritur te deshmoje paraqitjen e shtojcës 1 dhe shtojcës 2, sipas setit te DST qe APP ka publikuar ne Web app.gov.al dhe qe jane detyruara per zbatim nga cdo AK ne procedurat e vitit 2021 e ne vijim .

Per te permbushur plotesimin e kesaj pike Operatori Ekonomik "ARENA MK" shpk, ka paraqitur ne sistemin elektronik ofertën ekonomike sipas formatit të DST të mëparshme, format i cili është shfuqizuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KVO konstaton se shtojca e formularit të ofertës, e paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës, nuk është sipas formatit të hartuar e miratuar nga A.P.P si dhe DST te publikuar në sistemin elektronik per kete procedure prokurimi te shpallur nga AK.

Formulari i ofertës i paraqitur nga Operatori Ekonomik, nuk është përshtatur me ndryshimet ligjore që ka pësuar legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.

Konkretisht, Operatori Ekonomik: " ARENA MK" shpk, nuk e ka plotësuar shtojcën 1 sipas DST të publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik në faqen elektronike të APP. Operatori Ekonomik pjesëmarrës ka modifikuar shtojcën 1 "Formulari i ofertës", duke hequr pikat a, b, c, dhe d nga formulari.

Gjithashtu Operatori Ekonomik "Arena MK" shpk, nuk ka paraqitur, në SPE, shtojcën 2 të DST. Referuar ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik" neni 74 , pika 1, ku parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike", VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" neni 24. Në rregullat e prokurimit publik, në DST, në seksionin B "Përgatitja e Ofertave" konkretisht pika 4, parashikohet se;

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar;

Operatori Ekonomik pjesëmarrës, ka qenë i detyruar ti plotësojë shtojcat sipas rregullave të prokurimit publik.

Mosplotësimi i shtojcës 1 Formulari i Ofertës dhe shtojcës 2 “Lista e cmimeve të shërbimeve” sipas rregullave të prokurimit publik, bie në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe rregullat e prokurimit publik, në Dokumentat Standarte të Tenderit.

KVO vlereson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori Ekonomik “ARENA MK” shpk, nuk është i saktë dhe sipas dokumentave të cilat janë aktualisht në fuqi.

Dokumentet e tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ia vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit e si rrjedhojë edhe operatorët ekonomikë duhet të përdorin këto dokumenta.

Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi dhe është publikura vendimi i APP, për miratimin e DST per vitin 2021, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të dokumentave standarde të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe rrjedhimisht, operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë të detyruar të plotësojnë këto dokumenta.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Rrjedhimisht, gjykojmë se, ky dokument nuk përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për atë çka shërben dhe është i destinuar, duke mos qenë në përputhje me LPP dhe RrPP.

Përsa cituam më lart Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendos skualifikimin e Operatorit Ekonomik “ARENA MK”shpk.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Operatorin Ekonomik “A & E ENGINEERING” sh.p.k, me adresë: Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.10, Rruga Islam Alla, pallati IVEA 3/5*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **2,893,629** (dymilion e tetëqind e nëntëdhjetë e tremijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë) **leke pa tvsh** / totali i pikëve të marra 100 (njëqind) është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik.